

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm gjyqtarja Elife Uka, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mervete Krasniqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit T.Z për shkak të veprës penale Ndryshim i njësorit të shërbimeve nga neni 323, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP.II.nr.561/16, të datës 30.05.2017, në Prezencën e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit, me dt. 24.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit T.Z i biri i S. dhe nënës K. e gjinisë Z., i lindur me dt... , në P, ku edhe jeton në Rr."J.R " nr.,ka të kryer shkollën e mesme, pronar i "M.S", i martuar , baba i 2 fëmijëve ,shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovë, identiteti i të pandehurit vërtetohet nga letërnjoftimi me nr. personal ...

ËSHTË FAJTORË

Sepse

Me date 22.06.2015 është vërtetuar se në shtëpinë e tij në Prishtinë ne rrugën "J.R" nr., i pandehuri në njësorin elektrik nr... pllompat shtetërore i ka të manipuluar, të hapura dhe pastaj të mbyllura si dhe ka ndërhyre ne numëruesin e njësorit në të cilin ka gjurme të gërvishtjes të numrave në numërorë, në këtë mënyre ka penguar regjistrimin e sakte të energjisë së shpenzuar elektrike, me çast i ka shkaktuar dem KEDS-it ne vlere prej 81.47 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale Ndryshim i njësorit të shërbimeve nga neni 323 të KPRK-së.

Andaj, duke u bazua në nenin 3,50,51,52,53,73,74, nenit 320 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 €. e që dënimin me burg nuk do ta mbaj dhe se dënimin me gjobë nuk do ta paguaj po që se i njëjti në afat prej një (1) viti nuk do të kryej veprë të re penale.

Në rast të revokimit të dënimin me kusht, i pandehuri do të mbaj 6 muaj burë dhe dënimi me gjobë do të ekzekutohet menjëherë dhe në rast mos pagesë do të i zëvendësohet në dënim me burg ashtu që për 1 (një) një ditë burgim do të i llogariten 20 €.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës KEDS-i në emër të kompensimit të dëmit ti paguaj shumën prej 81.47 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

OBLIGOHET i pandehuri që të i paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të bëhen sipas llogarisë së kësaj gjykate ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 50 € në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë i ka parashtruar kësaj gjykate aktakuzën PP.II.nr.561/16, të datës 30.05.2017, kundër të akuzuarit T.Z për shkak të veprës penale Ndryshim i njësorit të shërbimeve nga neni 323, të KPRK-së, dhe ka propozuar që gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit

I pandehuri T.R në shqyrtimin fillestar në tersi e ka pranuar fajësinë në kuptim të nenit 326, par. 1, të KPRK, për veprën penale për të cilën e ngarkon Prokuroria e Shtetit, dhe se gjykata ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248, par. 1, po të këtij kodi, përkatësisht vlerësoj se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe mbështetet në faktet dhe provat që mbështetin aktakuzën.

Gjatë matjes së dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform të nenit 73, të KPRK, ashtu që rrethana rënduese nuk gjeti, kurse si rrethanë lehtësuese ka marrë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në seancën fillestare, se kishte sjellje korrekte, ka shprehur pendim të thellë, si dhe premtim se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin ashtu që gjykata e ka gjykuar me dënim të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të pandehurit rrezikshmërisë reale shoqërore të veprës penale, do të i shërbejë si preventivës individuale ashtu dhe gjenerale, do të parandaloj që në të ardhmen mos të kryejë vepra penale, do të bëjë rehabilitimin e tij si dhe do të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 41, e që mund të arrihet edhe pa ekzekutimi e tij.

Mbi kërkesën pasurore juridike është vendosur në konformë të nenit 463, par.2, të KPRK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale, është vendosur në konform të nenit 450, të KPRK.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365, të KPRK-së, u vendos i në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 2595/2017 i dt.25.05.2018

Procesmbajtësja
Mervete Krasniqi

G j y q t a r j a
Elife Uka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes